

YLLI BARDHI

Libri i mësuësit

QYTETARI 6

SHBLSH E RE

Libri i mësuesit

QYTETARI 6

AUTOR

Ylli Bardhi

Redaktore letrare

Lisina Mano

**Redaktore
Përgjegjëse**

Estela Mano

Kopertina:

Besa Mati

ISBN: 99899943-2-517-7

Botim 2026

SHBLSH E RE

Rruga Mine Peza, 1/1

Tiranë

www.shblsh.com

info@shblsh.com

Hyrje në Qytetari 6

Edukimi për qytetari demokratike dhe edukimi për të drejtat e njeriut (EQD/EDNJ), është pjesë e politikës arsimore në Shqipëri, në përmbushje të synimit të saj bazë në drejtim të krijimit të një kulture demokratike dhe pajisjes së individëve me kompetenca për jetën.

Në themel të tij qëndrojnë kompetencat për kulturën demokratike të Kornizës Referuese të Këshillit të Europës, e mbështesin të gjitha kurrikulat e edukimit qytetar, pjesë e kurrikulës zyrtare të arsimit parauniversitar për klasat 1-10.

Këto kompetenca janë baza për ndërtimin e përmbajtjes së lëndës së qytetarisë.

Ato shprehen dhe nënkuptohen shprehimisht në fushat, dimensionet, idetë, konceptet, objektivat etj., e kësaj kurrikule, të cilat janë të përafuara horizontalisht dhe vertikalisht me standardet dhe praktikatat e KE.

Ndryshimet e përshtatura me kurrikulën ekzistuese shënojnë progres dhe janë në përputhje me politikën dinamike të KE-së të njëzet viteve të fundit.

Kurrikula e shkruar pasqyron konceptet dhe praktikatat e përditësuara të dokumenteve të KE.

Kurrikula e qytetarisë është në përputhje me konceptet, praktikatat dhe pritshmëritë e KE, të EQD / EDNJ, pasi ato përfshijnë koncepte të parashikuara në Kartën e Këshillit të Europës.

Përmbajtja e lëndës “Qytetari 6” trajton jo vetëm realitetin shqiptar, si të ndryshuar dhe ende në ndryshim, problemet dhe sfidat përkatëse, por edhe realitetin evropian dhe global.

Si e tillë, kurrikula e kësaj lënde është përballur vazhdimisht me sfidën e ndryshimit dhe përshtatjes me faktorët: lokalë, ekonomikë, socialë, kulturorë, por edhe nga këndvështrimi i angazhimit të vendit për integrim drejt anëtarësimit të tij të ardhshëm në BE.

Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)

Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.

Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.

Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.

Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë kritike dhe krijuese)

Zgjidh një problem (shoqëror, shkencor, etj.) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse. Përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e problemit (shkencor, shoqëror). Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore.

Kompetenca e të nxënësve (Nxënësi mëson për të nxënë)

Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, medie) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon)

Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.

Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.

Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkë projekti / aktiviteti në bazë klase / shkolle.

Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)

Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes dhe respektimit në një shoqëri ku individët janë të ndryshëm por të barabartë.

Shpjegon në forma të ndryshme të shprehurit pra e respektimit dhe zbatimit të rregullave dhe ligjeve në një shoqëri ku në themel qëndron barazia.

Kompetenca personale

Nxit të nxënësve e bazuar në kërkim, duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Nxënësi kupton rolin e tyre në procesin e të nxënësve dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive dhe shkathtësive, dhe në marrjen e vendimeve.

Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)

Përdor teknologjinë për të marrë informacion shtesë në lidhje me mësimin.

Përdor programet kompjuterike për të zgjidhur detyra, projekte.

Rezultatet e të nxënësve të kompetencave kyç që realizohen nëpërmjet lëndës së qytetarisë

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)

Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.

Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.

Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.

Veçon informacionin kryesor nga një libër, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim.

Kompetenca e të menduarit

(Nxënësi mendon në mënyrë kritike dhe krijuese)

Parashtron argumente pro ose kundër për një temë / problem të caktuar gjatë një debati televiziv, radio ose publikimi në medie.

Zgjidh një problem (shoqëror, shkencor, etj.) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

Përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (shkencor, shoqëror).

Shpjegon mënyrën e zhvillimit të një procesi natyror ose shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë.

Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore.

Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore.

Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)

Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme: libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet, të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.

Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, medie) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në formë të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike. Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur. Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre /aktiviteti (në klasë / shkollë apo në terren).

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

(Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)

Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.

Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për shmangien e tyre.

Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin së bashku të një: (projekti / aktiviteti në bazë klase / shkolle apo jashtë saj).

Kompetenca personale

(Nxënësi bën jetë të shëndetshme)

Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme konflikti midis moshatarëve ose grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.

Kompetenca qytetare

(Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)

Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.

Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

Kultivon identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
Përvetëson vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
Zhvillohet në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
Zhvillon përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit.
Argumenton që kompetenca qytetare zhvillohet duke u bazuar në njohuritë për ligjësitë dhe konceptet themelore të demokracisë, të drejtësisë, të barazisë, të qytetarisë dhe të të drejtave të njeriut. Argumenton që kompetenca qytetare bazohet në njohuritë historike për ngjarjet dhe prirjet themelore të zhvillimit të historisë së njerëzimit dhe asaj kombëtare, në njohuritë për ligjësitë dhe ngjarjet bashkëkohore dhe në prirjet për të ardhmen.
Vlerëson diversitetin, respekton të tjerët dhe përgatitet për të kapërcyer paragjykimet dhe për të arritur kompromise. Pranon rëndësinë që ka kompetenca qytetare për reflektimin kritik e krijues dhe për pjesëmarrjen konstruktive në veprimtaritë e komunitetit ose të fqinjësisë si dhe në proceset e vendimmarrjes, veçanërisht përmes votimit, në nivel vendor, kombëtar dhe europian.

Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur risitë)

Përdor teknologjinë për të marrë informacion shtesë në lidhje me mësimin.
Përdor programet kompjuterike për të zgjidhur detyra, projekte.

Kompetenca të fushës. Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave fushës/ lëndës

Hulumtimi i dukurive shoqërore (politike, ligjore, qytetare, ekonomike, etike etj.)

Nxënësi:

Përzgjedh dhe hulumton një dukuri, çështje, temë të caktuar.

Hamendëson përgjigjet dhe përfundimet mbi bazën e njohurive paraprake dhe përcakton hapat për konfirmimin e tyre.

Harton instrumentet e nevojshme të grumbullimit të fakteve për objektin e hulumtimit shkencor.

Kërkon marrëdhëniet shkak - pasojë të dukurive shoqërore, ndërveprimin dhe kushtëzimin e tyre të ndërsjellë në nivel lokal dhe global.

Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi

Identifikon dhe shqyrton burimet e informacionit që përdor për kërkim.

Vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre.

Mbledh, përzgjedh dhe regjistron të dhëna për dukuritë shoqërore, duke shfrytëzuar burimet e drejtpërdrejta parësore (intervista, statistika) dhe dytësore (grafikë, ilustrime etj.).

Ndërton njohuri për mjedisin shoqëror, local dhe global për proceset dhe dukuritë shoqërore, për rajonet dhe veçoritë e tyre, ndërvarësinë, bashkëveprimin midis tyre në nivel kombëtar, rajonal dhe global duke përdorur mjetet e larmishme të informacionit.

Komunikon (me shkrim, me gojë, grafikisht) informacionin për dukuritë, ngjarjet, çështjet historike, shoqërore, politike, ekonomike, ligjore, kulturore, etike.

Marrja e vendimeve

Nxënësi:

Kombinon të dhëna dhe informacion për të nxjerrë konkluzione, duke marrë në konsideratë ndikimin e tyre.

Identifikon rrugë të ndryshme të veprimit dhe parashikon pasojat për to.

Propozon alternative, strategji ose zgjidhje për çështjet shoqërore dhe jep argumente për zgjidhjen e preferuar.

Përdor pyetje për të reflektuar në çdo hap të kërkimit:

“Çfarë funksioni?” “Si mund të përmirësohet?”

Nr	Tematikat	Shpërndarja e përmbajtjes së lëndës		
		Shtator – Dhjetor Kultura 13 orë + 1 orë nga Komuniteti	Janar – Mars 12 orë	Prill - Qershor 9 orë
1	I. Kultura 13 orë	1.1 Kultura dhe larmia e saj		
2		1.2 Diversiteti kulturor		
3		1.3 Stereotipat kulturorë		
4		1.4 Simbolet kulturore		
5		1.5 Feja dhe media		
6		1.6 Edukimi me bashkëekzistencën paqësore		
7		1.7 – 1.8 Veprimtari: “Kultura ime, kultura jonë, kultura e të gjithëve”.		
8				
9		1.9 – 1.10 Projekt: Rreziqet dhe përfitimet e teknologjisë		
10				
11			1.11 Konfliktet dhe dallimet kulturore	
12		1.12 Zgjidhja e konflikteve.		
13		1.13 Test – Përsëritje		
14	II.Komuniteti 1 ore	2.1 Çfarë është komuniteti?		

Nr	Tematikat	Shpërndarja e përmbajtjes së lëndës		
		Shtator – Dhjetor 14 orë	Janar – Mars Komuniteti - 12 orë	Prill - Qershor 9 orë
2	II.Komuniteti 12 orë		2.2 Llojet e komunitetit	
3			2.3 Shërbimet në komunitet	
4			2.4 Të njohim komunitetin pranë nesh: Komuniteti urban dhe komuniteti rural	
5			2.5 Ndryshimet brenda komunitetit. Ndryshimet sasiore dhe ndryshime cilësore	
6			2.6 -7 Projekt: Rreziqet dhe përfitimet e teknologjisë	
7				
8			2.8 Institucione pranë komunitetit	
9			2.9 Reagimi qytetar në shërbim të komunitetit	
10			2.10 Korrupsioni	
11			2.11 Pasojat e korrupsionit dhe si ta luftojmë atë	
12			2.12 Përsëritje	
13			2.13 Test	

Nr	Tematikat	<u>Shpërndarja e përmbajtjes së lëndës</u>		
		Shtator – Dhjetor 14 orë	Janar – Mars Komuniteti 12 orë	Prill - Qershor Globalizmi 9 orë
1				3.1 Projekt
2				Rreziqet dhe përfitimet e teknologjisë
3				3.2 Tregtia
4				3.3 Barrierat dhe marrëveshjet tregtare
5				3.4 Bëjmë një marrëveshje
6				3.5 Roli i individëve si burime njerëzore
7				3.6 Bota e fjalëve
8				3.7 Bota e pronave
9				3.8 Projekt
				3.9 Përsëritje Test

SHTATOR - DHJETOR	JANAR - MARS	PRILL - QERSHOR	GJITHSEJ	%
14 orë	12 orë	9 orë	35 orë	100%
9 orë Teori	8 Teori	6 orë Teori	23 orë Teori	66%
2 orë V. Praktike		-	2 orë V. praktike	5%
2 orë Projekt	2 orë Projekt	2 orë projekt	6 orë projekt	18%
1 orë Test – Përsëritje	1 orë Test – 1 orë P	1 orë Test – Përsëritje	4 orë Test – Persëritje	10%
Ndarjet Totali				100%

PLANIFIKIMI I PERIUDHËS SE PARË

SHTATOR - DHJETOR 14 jave

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI

LËNDA: QYTETARI Klasa: VI Shkalla: II

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE

Tematika I: Kultura

- Të dallojë faktin që individë të ndryshëm në grupin, në klasën, ku bën pjesë, kanë pikëpamje dhe përjetime të ndryshme për ngjarje, njerëz ose përvoja të ndryshme.
- Të lidhë pikëpamjet e tiparet e ndryshme që janë karakteristikë e disa grupeve me përkatësinë e tyre kulturore;
- Të përcaktojë kulturën dhe të përshkruajë elementët përbërës të kulturës.
- Të shpjegojë shprehje të ndryshme kulturore me faktorët e padukshëm që qëndrojnë në themel të tyre.
- Të shohë veten si pjesë të një kulture dhe ndikimin e saj në mënyrën e të menduarit dhe të sjellurit.
- Të tregojë respekt dhe empati për këndvështrimet e ndryshme kulturore.
- Të dallojë dhe të përshkruajë shembuj të ndikimit që ka përkatësia kulturore në qëndrimet e tyre.
- Të dallojë raste konfliktesh që shkatohen nga qëndrime të ndryshme që njerëz nga kultura ose nënkultura të ndryshme mbajnë ndaj të njëjtës sjellje ose dukuri.
- Të eksplorojë disa nga shkaqet e konflikteve, të tregojë disa nga pasojat e tyre dhe të sygjerojë mënyrën e parandalimit dhe zgjidhjes së tyre në shërbim të së mirës së përbashkët.
- Të dallojë hapat për trajnimin dhe zgjidhjen e një konflikti si pjesë e një modeli për t'u zbatuar në raste të tjera.

Nr	Tematika	Tema mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë	Vlerësimi	Burimet
1	I.Kultura	1.1 Kultura dhe larmia e saj	Jepen në videoprojektor disa veshje popullore nga krahina të ndryshme shqiptare. Pyetje të hapura: - Çfarë simbolizojnë këto veshje popullore? -A keni veshur ndonjëherë një kostum popullor?	PNP. Pyetje-përgjigje, ditari dypjesësh, punë individuale.	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti
2		1.2 Diversiteti kulturor	Mësuesi dhe nxënësit diskutojnë për foton që paraqet një bashkësi lapsash me ngjyra të ndryshme. Pyetje të hapura; Çfarë tregon foto në tekst? -A është diversiteti kulturor një vlerë e shoqërisë tonë?	PNP. Pyetje-përgjigje, ditari dypjesësh, punë individuale.	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti
3		1.3 Stereotipat kulturor	Jepet në videoprojektor një foto e një burri që kryen punët e shtëpisë. Pyetje të hapura: Çfarë tregon kjo foto? -Si janë ndarë rolet në familjen tuaj?	PNP. Pyetje-përgjigje, ditari dypjesësh, punë individuale.	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti
4		1.4 Simbolet kulturore	Në foto jepet foto e një fustani dasme të nuses. Pyetje: Çfarë ju sjell në mendje ky fustan? -A mund të vishet ky fustan për pushime?	PNP. Pyetje-përgjigje, ditari dypjesësh, punë individuale.	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti
5		1.5 Feja dhe media	Jepet në videoprojektor foto e 4 krerëve të besimeve fetare në Shqipëri gjatë ecjes së solidaritetit në Paris. Pyetje: Çfarë mesazhi përcjell kjo foto? - Cili është roli i medias në përcjelljen e mesazheve fetare?	PNP. Pyetje-përgjigje, ditari dypjesësh, punë individuale.	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti
6		1.6 Edukimi me bashkëjetesën paqësore	Jepet në videoprojektor foto e bashkëjetesës fetare. Pyetje: Çfarë mesazhi përcjell kjo foto? -Si e vlerësoni tolerancën fetare në Shqipëri?	PNP. Pyetje-përgjigje, ditari dypjesësh, punë individuale.	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti
7		1.7 Aktiviteti Kulturor Kultura ime Kultura jonë Kultura e të gjithëve	Lexim i orientuar në tekst	PNP. Puna me situatën,, puna në grupe, punë individuale.	Vlerësim me nivele	Teksti, int. Materiale të përgatitura nga nxënësit.

8		1.8 Aktivitet Kultura ime Kultura jonë Kultura e të gjithëve	Lexim i orientuar në tekst	PNP. Diskutim	Vlerësim nga përgjigjet e disk.	Teksti Interneti
9		1.9 Projekt Teknologjia Miku që na ndihmon Faza I		PNP. Diskutim, punë në grupe, punë individuale.	Vet vlerësim	Teksti Interneti
10		1.10 Projekt Teknologjia Menaxhimi Faza I		PNP. Diskutim, punë në grupe, punë individuale.	Vet vlerësim	Teksti Interneti
11		1.11 Konfliktet dhe dallimet kulturore	Në foto paraqitet foto e nxënësve në adoleshencë. Pyetje: çfarë dini ju për adoleshencën? - A jeni gjendur përballë një konflikti? Cili ishte shkak?	PNP. Puna me situatën, <i>harta e ideve,</i> <i>punë</i> <i>individuale.</i>	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti
12		1.12 Zgjidhja e konfliktit	Lexim i orientuar në tekst. Pyetje: Çfarë roli ka shkolla në zgjidhjen e konflikteve?	PNP. Pyetje- përgjigje, <i>ditari dy</i> <i>pjesësh, punë</i> <i>individuale.</i>	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti
13		1.13 Përsëritje Test		PNP. Punë <i>individuale</i>	Vlerësim nga diskutimi dhe Individual	Teksti Model standard
Nr	Tematika	Tema mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë	Vlerësimi	Burimet
1	II Komuniteti	2.1 Çfarë është komuniteti?	Lexim i orientuar Pyetje të hapura: - A keni vërejtur probleme në lagjen ku ju banoni? - Si është vepruar për zgjidhjen e tyre?	PNP. Pyetje - përgjigje, <i>ditari dy</i> <i>pjesësh,</i> <i>punë</i> <i>individuale.</i>	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti

PLANIFIKIMI I PERIUDHËS SE DYTË

JANAR - MARS 12 javë

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI

LËNDA: QYTETARI

Klasa: VI Shkalla: II

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE

Tematika II Komuniteti

- Të përkufizojë komunitetin.
- Të rendisë shërbimet qëduhet të kryhen në një komunitet në interes të të gjithë anëtarëve të komunitetit dhe për krijimin dhe ruajtjen e një komuniteti të shëndoshë.
- Të identifikojë raste kur pushteti vendor dhe institucione të tjera nuk i kanë kryer si duhet detyrat ndaj komunitetit dhe të eksplorojë shkaqet kryesore të një situatë të tillë.
- Të identifikojë rastet kur punonjësit e shtetit dhe të institucioneve të tij nuk tregohen të ndershëm dhe të përgjegjshëm për të kryer punët në shërbim të komunitetit, por e shfrytëzojnë postin për interesa vetjake.
- Të përcaktojë korrupsionin si një ndër shkaqet kryesore të shfytëzimit të punës së shtetit për interesa vetjake, si vënie e interesit vetjak kundër të mirës së përbashkët, si një ndër armiqtë kryesor të plotësisht të interesit të përbashkët në komunitet.
- Të përshkruajë raste dhe forma të ndryshme të korrupsionit.
- Të analizojë disa nga shkaqet e korrupsionit
- Të tregojë llojet e dëmeve që korrupsioni i shkatëron shoqërisë.
- Të tregojë disa nga format e korrupsionit që janë të pranishme në institucionin e shkollës.
- Të përshkruajë disa nga rrugët për të luftuar korrupsionin.
- Të argumentojë rëndësinë e edukimit për parandalimin e krijimit të kulturës që mbështet dhe mbanë gjallë korrupsionin.
- Të përcaktojë edukimin për integritet moral si një ndër edukimet që synojnë fuqizimin e individit për t'i bërë ballë korrupsionit dhe për të parandaluar atë.
Të përcaktojë disa nga drejtimet e edukimit për integritet moral që në bankat e shkollës.

Nr	Tematika II Komuniteti	Tema mësimore	Situata e të nxëniet	Metodologjia dhe veprimtaritë	Vlerësimi	Burimet
1		2.2 Llojet e komunitetit	Në foto paraqitet foto e nxënësve në shkollë. Pyetje: A përbën shkolla një komunitet? - Çfarë e bashkon komunitetin e shkollës?	PNP. Puna me situatën, <i>harta e ideve, punë individuale.</i>	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti
2		2.3 Shërbimet në komunitet	Lexim i orientuar Pyetje të hapura: - Çfarë janë shërbimet në komunitet? - Si i vlerësoni ju ato?	PNP. Puna me situatën, <i>harta e ideve, punë individuale.</i>	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti
3		2.4 Komuniteti urban Komuniteti rural	Lexim i orientuar Pyetje të hapura: - Pse Eldës i bëri përshtypje diskutimi i prindërve në takim? - Cilat mund të jenë shkaqet e rritjes së virozave në komunitete të mëdha urbane?	PNP. Puna me situatën, <i>harta e ideve, punë individuale.</i>	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti
4		2.5 Ndryshimet Në komunitet	Jepet në video-projektor foto e Tiranës (Para dhe pas viteve 1990). Pyetje: Krahaso këto dy foto? -Si ka ndryshuar kryeqyteti ynë?	PNP. Puna me situatën, <i>harta e ideve, punë individuale.</i>	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti
5		2.6 Faza 2 Projekt Si ndihmon Teknologjia Dobitë	Lexim i orientuar në tekst. (me ndihmën e tenologjisë të mbledhim të dhëna - grupet për kulturën dhe komunitetin)	Diskutim	Vet-vlerësim	Teksti Interneti
6		2.7 Faza 2 Projekt Teknologjia Rreziqet Përfundim	Lexim i orientuar ne tekst. (me ndihmën e teknologjisë të mbledhim të dhëna për kulturën dhe komunitetin, hapat)	Diskutim	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti
7		2.8 Institucionet pranë komunitetit	Në foto paraqitet foto e institucionit të bashkisë. Pyetje: Çfarë shërbimesh ofron bashkia në komunitet?	PNP. Pyetje-përgjigje, <i>ditari dypjesësh, punë individuale.</i>	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti
8		2.9 Reagimi qytetar	Jepet foto në videoprojektor nga një mjedis i papastër. Pyetje të hapura: - A duhet të heshtim apo të reagojmë? -Çfarë mund të ndryshojë nga reagimi qytetar?	PNP. Pyetje-përgjigje, <i>ditari dypjesësh, punë individuale.</i>	Vlerësim nga përgjigjet e disk.	Teksti Interneti
9		2.10 Korrupsioni	Lexim i orientuar në tekst. Pyetje: Çfarë është korrupsioni? Cilat janë format më të përhapura?	PNP. Puna me situatën, <i>ditari dypjesësh,</i>	Vet vlerësim	Teksti Interneti

10		2.11 Pasojat e korrupsionit. Lufta kundër tij	Lexim i orientuar në tekst. Pyetje: Çfarë pasojash vijnë nga korrupsioni?	PNP. Puna me situaten, <i>ditari dypjesësh, punë.ind.</i>	Vet vlerësim	Teksti Interneti
11		2.11 Konfliktet dhe dallimet kulturore	Në foto paraqitet foto e nxënësve në adoleshencë. Pyetje: çfarë dini ju për adoleshencën? - A jeni gjendur përballë një konflikti? Cili ishte shkak?	PNP. Puna me situatën, <i>harta e ideve, punë individuale.</i>	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti
12		2.12 Përsëritje	Diskutim rreth përgjigjeve të pyetjeve të tekstit.	Punë individuale, Punë në grupe.	Vlerësim nga diskutimet	Teksti Interneti
13		2.13 Test		Punë individuale	Vlerësim individual	Teksti

PLANIFIKIMI I PERIUdhës SE TRETË

PRILL - QERSHOR 9 javë

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI LËNDA: QYTETARI Klasa: VI Shkalla: II

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE

Tematika III: Tregu global

- Të përkufizojë tregtinë.
- Të shpjegojë pse vëndet zhvillojnë tregti me njëri-tjetrin.
- Të rendisë të paktën pesë produkte të importuara nga vende të tjera dhe të tregojë vendndodhjen e tyre në hartën e botës.
- Të identifikojë interesat, tarifrat, subvencionet, embargot dhe standartet si pengesa tregtare që qeveritë përdorin për të kontrolluar tregtinë dhe për të rritur përfitimet për vëndet e tyre.
- Të përshkruajë marrëveshjet shumëpalëshe mund të lehtësojnë tregtinë.
- Të përshkruajë rolin e OBT në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tregtare ndërmjet shteteve.
- Të shpjegojë aspektet kulturore të një biznesi ndryshojnë nga një vënd në tjetrin.
- Të zhvillojë plane grupi për të krijuar një biznes të tyre në fushën e ushqimit, duke mësuar nga praktikatat e biznesit të përzgjedhura nga vëndet e tjera.
- Të përshkruajë arsyet pse njerëzit lëvizin nga një vënd në tjetrin për arsye ekonomike.
- Të japë shembuj të kontributit të emigrantëve në vëndet e reja dhe të vështirësive të mëdha me të cilat ndeshen të porsaardhurit.
- Të shpjegojë tregtinë globale dhe emigrimin si mjete të shkëmbimit ndërkombëtar të burimeve njerëzore.
- Të llogarisë rendimentin.
- Te shpjegojë pse tregtia ndërkombëtare kërkon shkëmbimin e monedhave.
- Të këmbëjë lekun me monedha të tjera duke përdorur kursin e këmbimit.
- Të rendisë shembuj të zhvillimeve teknologjike përgjatë historisë.

Nr	Tematika III Tregu Global	Tema mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë	Vlerësimi	Burimet
1		3.1 Rreziqet dhe përfitimet nga teknologjia	Lexim i orientuar ne tekst	PNP. Diskutim, punë në grupe.	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti Materiale të përg. nga nxënësit.
2		3.2 Tregtia	Jepet foto një porti mallrash. Pyetje – Çfarë dini ju për tregtinë?	PNP. Pyetje- përgjigje, ditari dy- pjesësh, punë individuale.	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti
3		3.3 Barrierat dhe marrëveshjet tregtare	Jepet foto e tarifave doganore të SHBA-ve. Pyetje- A janë në favor të tregtisë tarifat?	PNP. Pyetje- përgjigje, ditari dy- pjesësh, punë individuale.	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti
4		3.4 Bëjmë një marrëveshje?	Jepet foto e OBT Pyetje- Çfarë roli ka kjo organizatë?	PNP. Pyetje- përgjigje, ditari dy- pjesësh, punë individuale.	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti
5		3.5 Roli i individëve si burime njerëzore.	<i>Jepet foto anije me emigrantë.. Pyetje - A është ekonomia arsyeja kryesore e emigracionit?</i>	PNP. Pyetje- përgjigje, ditari dy- pjesësh, punë individuale.	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti
6		3.6 Bota e fjalëve	Jepet foto e rrjeteve sociale.. Pyetje - Si ndikon teknologjia në ekonomi ?	PNP. Pyetje- përgjigje, ditari dy- pjesësh, punë individuale.	Vlerësim me nivele	Teksti Interneti
7		3.7 Bota e parave	Lexim i orientuar në tekst	PNP. Puna me situaten, , pune ne grupe, punë individuale.	Vlerësim me nivele	Teksti, int. Materiale të përgatitura nga nxënësit.
8		3.8 Projekt	Lexim i orientuar në tekst	PNP. Diskutim, punë në grupe.	Vlerësim nga diskutimet	Teksti Interneti
9		3.9 Test	Test Standard	Punë individuale	Vlerësim individual	Test Standard

Globalizmi, ose Tregu global/ **Projekti 2 orë**, ose i ndarë, fillim-fund, ose si të zgjedhë mësuesja, mund ta bëjë para Testit, në varësi të materialit që do të jepet nga Ministria.

DITARET

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: III	Klasa: VI	1.Dt / /
Tematika I: Kultura Tema mësimore: Kultura dhe larmia e saj.		Situata e të nxënit: Jepen në videoprojektor disa veshje popullore nga krahina të ndryshme shqiptare. Pyetje të hapura: - Çfarë simbolizojnë këto veshje popullore? - A keni veshur ndonjëherë një kostum popullor?		
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Tregon kuptimin e konceptit kulturë. - Përshkruan llojet e kulturave në botë. - Vlerëson ndryshimet që pëson kultura në vazhdimësi.			Fjalë kyçe: <i>Kulturë, Diversitet, Mozaik, Human</i>	
Burimet: Teksti, internet.		Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare: Gjeografia, Historia, Gjuha dhe komunikimi.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: PNP. Pyetje- përgjigje, ditari dypjesësh, punë individuale.				
Zhvillimi i mëimit: Hapi I:Parashikimi: Pyetje- përgjigje 5 ‘ Mësuesi-ja orienton diskutimin nëpërmjet pyetjes: -Çfarë është kultura? -Cilat janë disa nga traditat tona? Hapi II-Ditari 2 pjesësh- 15’ Ndahen nxënësit në 3 grupe dhe secilit grup i jepet për studim një çështje e caktuar. Grupet diskutojnë për 15’ duke plotësuar tabelën nëpërmjet fjalive pyetëse				
Grupet sipas çështjeve		Komenti		
Grupi 1: Çfarë është kultura?		<i>Çfarë është kultura? Argumento kuptimin e fjalës kulturë?</i>		
Grupi 2: Kultura në botë.		<i>Pershkruaj llojet e kulturave në botë?</i>		
Grupi 3: Kultura ndryshon vazhdimisht.		<i>Pse kultura ndryshon vazhdimisht?</i>		
Hapi III: Prezantimi i punës së grupeve - 15’ Secili grup prezanton gjetjet e veta, përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë, ndërkohë edhe nxënësit e grupeve të tjera plotësojnë në fletoren e tyre. Përforcimi Hapi IV: Përforcimi: Punë me tekstin – diskutim me të gjithë klasën 10’ Punohen dhe diskutohen pyetjet e tekstit: pas leximit - Punë e diferencuar - Tregon disa elementë të kulturës shqiptare.				

Vlerësimi: Bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit gjatë të gjitha fazave mësimore. Vihen në dukje rezultatet.

N 2- Tregon kuptimin e konceptit kulturë.

N 3- Përshkruan llojet e kulturave në botë.

N 4- Vlerëson ndryshimet që pëson kultura në vazhdimësi.

Detyrë: Pyet prindërit - Çfarë elementesh kulturorë kanë ndryshuar duke krahasuar fëmijërinë e tyre me brezin e sotshëm?

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: III	Klasa: VI	2.Dt / /
Tematika I: Kultura		Situata e të nxënësve:		
Tema mësimore: Diversiteti kulturor.		Mësuesi dhe nxënësit diskutojnë për foton që paraqet një bashkësi lapsash me ngjyra të ndryshme. Pyetje të hapura. Çfarë tregon foto në tekst? -A është diversiteti kulturor një vlerë e shoqërisë tonë?		
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:				Fjalë kyçe:
<ul style="list-style-type: none"> - Tregon kuptimin e konceptit "Diversitet". - Përshkruan rëndësinë e diversitetit kulturor. - Shpjegon dukuri të ndryshme kulturore. 				Diversitet, Dialekt.
Burimet: Teksti, internet.		Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare: Gjeografi, Historia, Gjuha dhe komunikimi.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: PNP. Puna me situaten, , ditari dypjesësh, punë individuale.				
Zhvillimi i mësimt:				
Hapi I:Parashikimi: veprimtari me situaten 5 ‘				
Mësuesi/ja i orienton nxënësit të lexojnë situatën në tekst. Ai/ Ajo parashtron disa pyetje për të drejtuar përgjigjet e nxënësve te tema e re.				
<ul style="list-style-type: none"> - Çfarë është diversiteti kulturor? - Çfarë gjëra interesante keni mësuar nga diversiteti kulturor në shkollë? 				
Hapi II-Ditari 2 pjesësh- 15’				
Ndahen nxënësit në 3 grupe dhe secilit grup i jepet per studim një ceshtje e caktuar. Grupet diskutojnë për 15’ duke plotësuar tabelën nëpërmjet fjalive pyetëse.				

Grupet sipas çështjeve	Komenti
Grupi 1: Origjina dhe kuptimi i fjalës “Diversitet”.	<ul style="list-style-type: none"> • Fjala ‘diversitet’ vjen nga fjala latine “diversus” që do të thotë i ndryshëm. • Ajo përdoret për të shpjeguar praninë e shumë lloje, formave ose zakoneve kulturore brenda një të njëjtit grup njerëzish. • Larmia kulturore vlen shumë sepse e pasuron komunitetin. •
Grupi 2: Pse ka rëndësi diversiteti kulturor?	<ul style="list-style-type: none"> • E pasqyron jetën tuaj me mënyra të reja të menduarit. • Ju mëson të respektoni njerëzit që janë të ndryshëm nga ju. • Ndihmon në bashkëjetesë paqësore, sepse kur kuptoni kulturat e të tjerëve, jeni më të hapur dhe kuptoni më shumë. • Ndërton urë lidhëse, ju afron me komunitete të tjera.
Grupi 3: Dukuri të ndryshme kulturore.	<p><i>-Nënkultura është një grupnjerëzish brenda shoqërisë që ka tradita, zakone, veshje, gjuhë ose interesa të vecanta, që i dallojnë nga të tjerët.</i></p> <p><i>-Kunderkultura është një grup njerëzish që nuk pajtohen me disa rregulla, zakone apo vlera të shoqërisë dhe kërkojnë të jetojnë ndryshe nga pjesa tjetër e shoqërisë.</i></p> <p><i>-Dialektet janë mënyra të ndryshme të të folurit që tregojnë hitorinë, traditat dhe kulturën në zona të ndryshme të Shqipërisë.</i></p>

Hapi III: Prezantimi i punës së grupeve- 15’

Secili grup prezanton gjetjet e veta, përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë , ndërkohë edhe nxënësit e grupeve të tjera plotësojnë në fletoren e tyre.

Përforcimi

Hapi IV: Përforcimi: Punë me tekstin – diskutim me të gjithë klasën 10’

Punohen dhe diskutohen pyetjet e tekstit: pas leximit

- **Punë e diferencuar-** Tregon disa dialekte të ndryshme në Shqipëri ?

Vlerësimi:

Bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimi gjatë të gjitha fazave mësimore. Vihen në dukje rezultatet.

N 2- Tregon kuptimin e konceptit “Diversitet”.

- *N 3- Përshkruan rëndësinë e diversitetit kulturor.*

N 4- Shpjegon dukuri të ndryshme kulturore.

Detyrë:

Ese; Diversiteti kulturor është vlerë e shoqërisë tonë.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: III	Klasa: VI	3. Dt / /
Tematika V: Kultura.		Situata e të nxënit:		
Tema mësimore: Stereotipat kulturorë.		Jepet në videoprojektor një foto e një burri që kryen punët e shtëpisë. Pyetje të hapura: Çfarë tregon kjo foto? -Si janë ndarë rolet në familjen tuaj?		
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			Fjalë kyçe:	
<ul style="list-style-type: none"> - Tregon pse krijohen stereotipat. - Përshkruan stereotipat gjinorë. - Gjykon si t'i sfidojmë stereotipat gjinorë. 			Stereotip, Lidership	
Burimet: Teksti, internet.		Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare: Historia, Gjuha dhe komunikimi.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: PNP. Puna me situaten, ditari dypjesësh, punë individuale.				
Zhvillimi i mësimi:				
Hapi I:Parashikimi: veprimtari me situaten 5 ‘				
Mësuesi i orienton nxënësit të lexojnë situatën në tekst. Ai/ajo u parashtron disa pyetje për të drejtuar përgjigjet e nxënësve te tema e re. Disa nga pyetjet mund të jenë:				
<ul style="list-style-type: none"> - Çfarë janë stereotipat? - Si ndahen stereotipat? 				
Hapi II-Ditari 2 pjesësh- 15’				
Ndahen nxënësit në 3 grupe dhe secilit grup i jepet per studim një çështje e caktuar. Grupet diskutojnë për 15’ duke plotësuar tabelën nëpërmjet fjalive pyetëse				
Grupet sipas çështjeve	Komenti			
Grupi 1: Pse krijohen stereotipat?	<ul style="list-style-type: none"> • Traditadhe zakone të trashëguara. • Mungesa e kontaktit me kultura të tjera. • Pamja e njëanëshme e medias. • Në disa raste, frika nga ndryshimet. • 			
Grupi 2: Stereotipat gjinorë.	<ul style="list-style-type: none"> • Djemtë janë më të fortë. • Vajzat duhet të merren me punët e shtëpisë. • Djemtë janë më të mirë në sporte. • Vajzat janë më të mira në shkencat ekzakte. 			
Grupi 3: Si t'i sfidojmë stereotipat kulturorë?	<ul style="list-style-type: none"> -Të njohim kultura të ndryshme, tradita dhe mënyra të reja jetese. -Të pyesni dhe të mësoni, në vënd që të paragjykoni. -Të kuptoni se mendimi i tjetrit respektohet, nuk përcakton karakterin e personit. 			

	-Të vëzhgoni shembuj pozitivë, ku burrat dhe gratë, vajzat dhe djemtë punojnë bashkë pa dallime.
<p>Hapi III: Prezantimi i punës së grupeve- 15' Secili grup prezanton gjetjet e veta, përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë, ndërkohë edhe nxënësit e grupeve të tjera plotësojnë në fletoren e tyre.</p> <p>Përforcimi</p> <p>Hapi IV: Përforcimi: Punë me tekstin – diskutim me të gjithë klasën 10' Punohen dhe diskutohen pyetjet e tekstit: pas leximit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Punë e diferencuar - <i>Jep disa shembuj stereotipash gjinorë.</i> 	
<p>Vlerësimi: Bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit gjatë të gjitha fazave mësimore. Vihen në dukje rezultatet.</p> <ul style="list-style-type: none"> - N 2- Tregon pse krijohen stereotipat. - N 3- Përshkruan stereotipat gjinorë. - N 4- Gjykon si t'i sfidojmë stereotipat gjinorë. 	
Detyrë: Shembulli im i sjelljes pa stereotipa.	

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: III	Klasa: VI	4 Dt / /
<p>Tematika I: Kultura.</p> <p>Tema mësimore: Simbolet kulturore</p>		<p>Situata e të nxënit: Në foto paqraçitet foto e një fustani dasme të nuses.</p> <p>Pyetje: Çfarë ju sjell në mendje ky fustan? - A mund të vishet ky fustan për pushime?</p>		
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tregon simbolet kulturore shqiptare dhe botërore. - Përshkruan rëndësinë e simboleve kulturore. - Shpjegon ndryshimin e simboleve kulturore me kohën. 			<p>Fjalë kyçe: <i>Simbol</i></p>	
<p>Burimet: Teksti, interneti.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare: Gjeografia, Historia, Gjuha dhe komunikimi.</p>		
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: PNP. Puna me situaten, harta e ideve, punë individuale.</p>				

Zhvillimi i mësimit:


Hapi I: Parashikimi: veprimtari me situaten 5 ‘

Nxënësit lexojnë situatën dhe drejtohet diskutimi nëpërmjet pyetjes:

-Çfarë janë simbolet kulturore?

Hapi II-Harta e ideve- 25’.

Nxënësit lexojnë materialin në tekst dhe plotësojnë hartën e ideve ne tabelë.



Hapi III: Prezantimi i punës së grupeve - 5’

Pergjigjet e nxënësve në tabelë shkruhen në fletoren e tyre.

Përforcimi

Hapi IV: Përforcimi: Punë me tekstin – diskutim me të gjithë klasën 10’

Punohen dhe diskutohen pyetjet e tekstit: pas leximit

- **Punë e diferencuar-** Tregon një simbol të kulturës tonë.

Vlerësimi: Bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit gjatë të gjitha fazave mësimore. Vihen në dukje rezultatet.

- N 2- Tregon simbolet kulturore shqiptare dhe botërore.

- N 3- Pershkruan rëndësinë e simboleve kulturore.

- N 4- Shpjegon ndryshimin e simboleve kulturore me kohën.

Detyrë:

Aktivitet krijues në tekst.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Qytetari	Shkalla: III	Klasa: VI	5 Dt / /
Tematika I: Kultura.		Situata e të nxënit:		
Tema mësimore:		Jepet në videoprojektor foto e 4 krerëve të besimeve fetare në Shqipëri gjatë ecjes së solidaritetit në Paris.		
Feja dhe media		Pyetje: Çfarë mesazhi përcjell kjo foto? - Cili është roli i medias në përcjelljen e mesazheve fetare?		
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:				Fjalë kyçe:
- Tregon rëndësinë e diversitetit fetar në botë.				<i>Sinagogë</i>
- Përshkruan rolin e medias në diversitetin fetar.				
- Shpjegon misionin e medias si urë komunikimi për të rinjtë.				
Burimet: Teksti, internet.		Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare: Historia, Gjuha dhe komunikimi.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: PNP. Puna me situatën, ditari dypjesësh, punë individuale.				
Zhvillimi i mësimi:				
Hapi I: Parashikimi: veprimtari me situatën 5 ‘				
Mësu				
Hapi II-Ditari 2 pjesësh- 15’				
Ndahen nxënësit në 3 grupe dhe secilit grup i jepet për studim një çështje e caktuar. Grupet diskutojnë për 15’ duke plotësuar tabelën nëpërmjet fjalive pyetëse				
Grupet sipas çështjeve		Komenti		
